

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
HotelGrup sh.p.k
Dispozita të përgjithshme**

Neni 1
EMËRTIMI

Sot me datë 24.05.2024 në bazë të Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKB-në" të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" me vullnetin e tij të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij statuti.

Ortaku si më poshtë:

Arben PALOKA

vendosi krijimin e shoqërisë

HotelGrup sh.p.k

Shoqëria e ka selinë në: **"Rruga e Shirokës Nr.9, Njësia Administrative Nr.1, Shkodër"**

Shoqëria ka të drejtë të çelë filial,degë, e përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë e jashtë saj,në përputhje me legjislacionin shqiptar e ato të vendeve të tjera ku ato do të hapen.

Arben PALOKA është administrator i shoqërisë për afat 5 vjeçar.

Neni 2

Shoqëria **HotelGrup sh.p.k** e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (statuti).

Shoqëria **HotelGrup sh.p.k** është Person Juridik

Neni 3

Shoqëria **HotelGrup sh.p.k** krijohet për të kryer veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje mbi 10(dhjetë) vjet.Shoqëria mund të zgjatë afatin e veprimtarisë së saj ose mund ta mbyllë aktivitetin e saj para këtij afati,sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut dhe sipas kriterieve që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

Neni 4

Shoqëria për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët,përgjigjet vetëm me pasurinë e saj.

Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e shoqërisë.

Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore,organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie

Neni 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë si objekt:

Hoteleri dhe shërbime të tjera hotelerie qe lidhen me akomodimin në hotel (furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese). Shërbime akomodimi në hotel (hoteleri).

Shërbim akomodimi në ambiente të ndryshme, me qëllim ofrimin e shërbimit të akomodimit.

KREU II
MARRËDHËNIET EKONOMIKO-FINANCIARE

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lekë.

I ndarë ky kapital në 1 pjesë, vlera nominale e së cilës është 100000 lekë.

Ky kapital themeltar zotërohet nga:

Arben PALOKA 100%

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve ashtu dhe përkundrejt pësonave të tretë. Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakëve dhe me akt notarial.

Nëqoftëse njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortakët e tjerë, ose aprovimin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij një subjekti tjetër.

Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të veçantë ose nga një ekspert kompetent i caktuar nga ortakët.

Neni 7

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit themeltar bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të veçantë.

Neni 8

Fitimet neto të realizuara nga aktiviteti i shoqërisë do të ndahen ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre pjesëmarrëse në kapitalin themeltar.

Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdive ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

Bilanci i aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet brenda muajit mars të vitit që vijnë.

Bilanci i aktivitetit finansiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertët e tyre.

Por në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit finansiar duhet të aprovoohen nga Asambleja e Ortakëve brenda muajve të mbylljes së vitit finansiar.

Neni 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit. Përberja e fondeve, burimet financiare të tyre caktohen nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 11

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

KREU III TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

Neni 12

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

- Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të kërkojnë dhe tu jepen të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).
- Të bëjë propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.
- Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

Neni 13

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe vendimet e Asamblesë (për fondin rezervë).
- Të marrin pjesë në administrimin nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

Neni 14

Organë më i lartë vendimarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Në Asamble marrin pjesë të gjithë Ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vendosura në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Miraton bilancin vjetor të shoqërisë
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themeltar.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Emëron dhe revokon ekspertin kontabël të shoqërisë.
- Kryen modifikime në statut sipas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj në një tip tjetër shoqërie.

Neni 15

Administratori i shoqërisë është **Arben PALOKA**, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në, me dhe për llogari të shoqërisë.

Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijnë nga veprimet e kryera nga administratori.

Administratori ka afat maksimal 5(pesë) vjet dhe afati është i detyrueshëm të parashikohet në aktet e shoqërisë.

Neni 16

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, si dhe shkelje të kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 17

Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë rregullohen me kontrata individuale që do të lidhen me se cilin prej tyre.

KREU V MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

Neni 18

Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratë nëqoftëse Ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk zgjatin këtë afat.

Shoqëria mund t'i japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 19

Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit.

Pasuria e shoqërisë, pasi shlyen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes Ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarëve të saj.

ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

HotelGrup sh.p.k

Arben PALOKA

Arben Paloka

Reffy